



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

---

Numri i lëndës: 2023:023323  
Datë: 09.08.2023  
Numri i dokumentit: 04570381

**C-IV.-13-0385**

*Ankuesi:*

**H I** nga Vitia të cilin e përfaqëson  
B I av nga Prishtina.

*Kundër:*

*E paditura:*

**N.SH “Letnica”**(në Likuidim), përfaqësuar nga  
**Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. “Dritan Hoxha” nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtari Shkelzen Sylaj, me 09 gusht 2023, lëshon këtë:

**A K T G J Y K I M**

- 1. APROVOHET** si e bazuar ankesa e ankuesit dhe ndryshohet vendimi i Autoritetit të Likuidimit të AKP-së GJI083-0015 i dt.14 mars 2013.
- 2. OBLIGOHET** e paditura AKP ti paguaj ankuesit H I në emër të dëmshpërblimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës, shumën prej 409.04€
- 3.** Shuma e aprovuar si në pikën 2 të dispozitivit do të përmbushet në pajtim të prioritetit sipas kategorisë së përcaktuar të kërkesave dhe interesave në procedurën e likuidimit.
- 4.** Secila palë i bart shpenzimet e veta.

**Rrethanat faktike dhe procedurale**

Me 02 prill 2013 ankuesi H I ish punëtor i NSH “Letnica” ka ushtruar ankesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovë (më tej “Dhoma e Posaçme”) kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit (tutje AL) nr. GJI083-0015 i dt.14 mars 2013, me të cilin ishte refuzuar

kërkesa e ankuesit për kompensimin për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shumë prej 409.04 €. Ankuesi në ankesë ka theksuar se ka qenë i punësuar për kohë të pacaktuar te N.SH “Letnica” dhe asnjëherë nuk i është ndërprerë marrëdhënia e punës deri me Letër Pezullimin e dt.12.06.2009. Ka shtuar se kërkesa e tij mbështet nga neni 40.1.6.2 i shtojcës së Ligjit nr.04/L-034. Ankesës i ka bashkangjitur: Kopjen e vendimit të kundërshtuar, Letër Pezullimin e dt.12.06.2009, Kopjen e Librezës së punës.

Me 19 maj 2014, e paditura AKP-ja ka parashtruar mbrojtje në ankesë, në të cilën pohoi se AL-ja ka kryer një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore janë zbatuar saktësisht. Po ashtu AKP-ja pohoi se ankuesi e ka pranuar letrën për ndërprerje të marrëdhënies së punës, mirëpo ankuesit kishte kohë që i ishte ndërprerë marrëdhënia e punë, kurse me Letër pezullimin e pranuar nga ankuesi të njëjtit i është dhënë e drejta që të përfitojë nga shpërndarja e fondit 20%. Po ashtu, shton se pohimet e ankuesit nuk mbështeten në listë të pagesave të N.SH-së, të cilat tregojnë se N.SH nuk e ka paguar parashtruesin gjatë periudhës prej 12 mujore që i parapriu privatizimit. I ka kërkuar gjykatës që të refuzoj ankesën e ankuesit si të pa pranueshme dhe të pa bazuar. Ankesës i ka bashkangjitur: Regjistrin nr.0373/09 dt.08.07.2009, Llogaria Totale nr.171/09 dt.14.04.2009, Llogaria Totale dt.15.06.2009.

Me parashtruesin e dt.21 korrik 2014 i autorizuari i ankuesit ka paraqitur kundërshtim në mbrojtjen e të paditurës, ku ndër të tjera ka theksuar se e vetmja arsye për ndërprerjen e marrëdhënies së punës është përgatitja e NSH-së për privatizim dhe kjo rrethanë nuk është varur nga vullneti i punëtorit.

Me 24 shtator 2014, e paditura ka paraqitur kundërpërgjigje në përgjigjen e ankuesit, ku ka pohuar se i konfirmon pohimet dhe qëndrimet ligjore të paraqitura në mbrojtje. E rithekson faktin se marrëdhënia e punës mes N.SH-së dhe parashtruesit është ndërprerë në momentin kur palët nuk kanë përmbushur detyrimet, pra kur parashtruesi ka ndaluar punën dhe NSH-ja e ka ndaluar pagesën ndaj tij.

### **Arsyetimi ligjor**

Ankesa e ankuesit aprovohet si e bazuar.

Në bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejshëm Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata nxjerrë këtë aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Gjykata ka shqyrtuar në tërësi të gjithë materialin e paraqitur në gjykatë nga të dyja palët dhe konstaton si në vijim.

Gjykata gjen se Agjencia Kosovare e Privatizimit – AL në rastin e vendosjes së kërkesës të ankuesit për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shumë prej 409,04 €, pa ndonjë arsye të bazuar këtë kërkesë e ka refuzuar si të pavlefshme. E paditura në rastin e ankuesit nuk ka zbatuar drejtë të drejtën materiale. Arsyetimi i vendimit nga ana e AL, se ankuesi nuk ishte në listën e pagave për 12 muajt e fundit para datës së nënshkrimit të kontratës së privatizimit, se nuk është kryer ndonjë pagesë dhe se nuk ka qenë punëtor aktiv i NSh-së me rastin e privatizimit, sipas gjykatës nuk është arsye bindëse dhe bazuar për refuzimin e kërkesës së parashtruesit.

Të qenit punëtor aktiv apo pasiv i N.SH-së, apo të mos jesh në listën e pagave apo të mos jetë bërë pagesa punëtorit mund të reflektoj në çështjen e pagave mujore gjatë kohës së punësimit, por kurrsesi nuk mund të ndikoj në të drejtën e tij për dëmshpërblimit për shkak të shkëputjes së marrëdhënies së parakohshme të punës që i takon punëtorëve konform nenit 40.1.6.2. të shtojcës së Ligjit Nr.04/L-034 për AKP-në. Neni në fjalë po ashtu nuk parasheh që punëtorët duhet të jenë në listën e pagave në kohen e privatizimit të N.Sh-për ti takuar dëmshpërblimi, ky nuk është kriter ligjor, prandaj mbrojtja e AKP-së, në këtë aspekt është e pabazuar.

Neni 40.1.6.2. i shtojcës së Ligjit Nr.04/L-034 për AKP-në, parasheh që punëtorëve u takon e drejta e dëmshpërblimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës nëse “*janë pushuar nga puna si rrjedhojë e Vendimit për Likuidim të ndërmarrjes, apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga Agjencia sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP-në*”. Privatizimi është një ndër veprimet e AKP-së të parapara me nenin 6.2.1 të Ligjit për AKP-në, prandaj kërkesa për dëmshpërblim e ankuesit për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies së punës është vlefshme dhe e bazuar.

Në shkresat e lëndës nuk ka asnjë dëshmi se ankuesit i është ndërprerë marrëdhënia e punës para privatizimit të N.SH-së. Gjykata nga letër pezullimi i dt. 12 qershor 2009 vëren se ndërprerja e marrëdhënies së punës tek ankuesi ka ndodhur si rezultat i privatizimit të N.SH “Letnica” me 11 qershor 2009, kur edhe është vërtetuar kontrata shitjes nga ana e Bordit të AKM-së. Me njoftim ankuesit i është bërë me dije se si rezultat i privatizimit të N.Sh-së i është ndërprerë marrëdhënia e punës dhe se të gjitha detyrimet do të mesin përgjegjësi i punëdhënësit e të cilat do të shqyrtohen kur të filloj procedura e likuidimit. Po ashtu ankuesit me dt. 11 qershor 2009 i është mbyllur edhe librezja e punës nga N.SH-ja, prandaj këto janë prova janë të mjaftueshme për të konstatuar se ankuesi ka qenë i punësuar në N.Sh-së dhe se marrëdhënia e tij e punës është ndërprerë nga e paditura si rezultat i privatizimit të N.Sh-së. Meqë AL në vendimin e saj nuk e ka kontestuar lartësinë e dëmshpërblimit të kërkuar nga ankuesi, gjykata nuk ka nevojë ta provojë këtë.

Pra nga ajo që u tha më lart gjykata vjen në përfundim se vetëm ndërprerja e mëhershme e marrëdhënies së punës para privatizimit, ankuesit do ja pamundësonte dëmshpërblimin, por kjo nuk ka ndodhur. Prandaj vendimi i AL është i pa drejtë dhe jo ligjor dhe si i tillë anulohet.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

### **Shpenzimet gjyqësore**

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta. Në pajtim me nenin 13.3 të Udhëzimit Administrativ për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) nr. 01/2017, të datës 22 mars 2017, ankuesi nuk ngarkohet me taksë gjyqësore, meqë vlera e kontestit është nënë shumën prej 1000 €.

### **Këshilla juridike**

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim tek Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme brenda 15 ditësh nga data e pranimiit. Ankesa duhet të parashtrohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Gj y q t a r i  
**Shkelzen Sylaj**